

ZHVILLIMI I FUQISË PUNËTORE, STRATEGJI KRYESORE NË PËRMIRËSIMIN E POZITËS KONKURRUESE


# USAID vazhdon të ndihmojë

USAID-i po vazhdon ndihmën për të rinjtë kosovarë, duke iu ofruar trajnime dhe programe të praktikës për studentët e universitetit dhe deri më tani, e gjithë kjo ka dhënë rezultate në punësimin profesional për gjithsej 75 të rinj

Valon Peci

**D**rejtor i KPEP-it, Mark Wood, ka thënë se USAID-i e konsideron zhvillimin e fuqisë punëtore si strategji kryesore në përmirësimin e pozitës konkurruese të kompanive dhe sektorëve të Kosovës. Sipas Wood, e gjithë ekonomia e Kosovës po lëviz drejt shekullit 21. Ai theksoi se konkurrenca në treg, zhvillimi i shkathtësive për pjesëmarrësit aktualë dhe të ardhshëm të fuqisë punëtore dhe qasja e studentëve dhe e të papunëve në vende pune e profesione të reja, do të jetë kërkesë thelbësore. "Për t'iu ofruar studentëve, të papunëve dhe të punësuarve aktualë shkathtësitë të cilat i përshtaten më mirë biznesit, Programi për Ndërmarrje Private në Kosovë ka organizuar disa programe të praktikës" tha Wood.

Trajnimi dhe programi i praktikës në kontabilitet dhe financa, i implementuar nga Shoqata për Shërbime Financiare dhe Kontabilitetit (AFAS), ka inkuadruar 103 studentë të ekonomisë. Këta studentë kanë ndjekur programin e trajnimit dhe u vendosën si praktikantë



nëpër banka dhe institucione mikrofinanciare. Deri më sot, 59 studentëve u janë vazhduar kontratat.

Nga programi i praktikës për fusha të ndryshme, i implementuar nga World University Service - Austria (WUS - Austria), përfituan 40 studentë. Këta studentë u vendosën në ministri dhe drejtori të ndryshme komunale të pesë komunave. Deri më tani, 2 prej tyre u është ofruar mundësi punësimi permanent.

Programi i praktikës për sektorin e prodhimeve të qumështit, i implementuar nga Nisma për Zhvillim të Bujqësisë së Kosovës (IADK), ka inkuadruar 15 praktikantë: 10 studentë fillestarë dhe

5 mentorë, të cilët ishin zgjedhur nga pilot grupi i programit të vitit 2009. Programi prapë dëshmoi të jetë shumë i suksesshëm për shkak se edhe cilësia e qumështit të prodhuar nga fermerët, që ishte po ashtu pjesë e programit, është përmirësuar, si dhe

Programi i praktikës për industrinë e përpunimit të drurit, i implementuar nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPDK), i angazhoi 16 studentë nga Fakulteti i Shkencave Aplikative dhe nga Shkolla Profesionale dhe të Zdrukthëtarisë dhe Qendra për Aftësim Profesional, të gjithë klientë të KPEP-it.

Ky projekt ishte shumë i suksesshëm për shkak se 16 studentëve u është ofruar punësim nga kompanitë ku ishin të vendosur për praktikë. Deri më sot, 14 prej tyre i kanë pranuar ofertat për punë.

Programi për Ndërmarrje Private në Kosovë i USAID-it është një nismë katër vjeçare e filluar në tetor 2008 dhe synon stimulimin e aftësisë konkurruese të sektorit privat në ekonominë e Kosovës.